

**Katër arsye se pse
ti mund të
buzëqeshësh**



SMILE



Buzëqeshja 1: Zoti ju do sinqerisht

“Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.” (Gjoni 3:16 ALB)

Sido që të ndihesh, ose çfarëdo lloj gjëje të kesh kaluar, fuqia e dashurisë së Zotit për ty nuk ka për të ndryshuar. Ai dha birin e Tij të vetëm në këmbim për ty!



Buzëqeshja 2: Jezusi vdiq për ty

Dashuria e vërtet tregohet kur një person është i gatshëm të japi jetën e tij për një mik. Nuk ka dashuri më të madhe se kjo. Vetë historia tregon që Jezusi jetoi dhe vdiq në kryq. Bibla thot që Ai e bëri këtë për ty dhe për mua.

**“sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë,”
(Romakëve 3:23)**

**“Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne.”
(Romakëve 5:8)**

**“Sepse paga e mëkatit është vdekja, por dhuntia e Perëndisë është jeta e përjetshme në Jezus Krishtin, Zotin tonë.”
(Romakëve 6:23)**

**“i cili(Jezusi) u dha për shkak të fyerjeve tona dhe u ringjall për justifikimin tonë.”
(Romakëve 4:25)**



Buzëqeshja 3: Zoti ka një qëllim për jetën tënde

“Sepse unë i njoh mendimet që kam për ju,” thotë Zoti, “mendime paqeje dhe jo të së keqes, për t’ju dhënë një të ardhme dhe një shpresë.” (Jeremia 29:11)

Çdo kryevepër ka një krijues.

Brenda çdo kryevepre ekziston një qëllim për të cilën u krijua. Ti je i veçant në sytë e Zotit dhe Ai ka një qëllim për jetën tënde. Qëllimi i parë i Zotit për jetën tënde është që ti të njohësh dhe të kuptosh dashurinë e Tij. Çdo gjë tjetër do qartësohet teksa ti beson tek Ai.



Buzëqeshja 4: Sot është dita e duhur

“sepse ai thotë: “Në kohë të pëlqyer unë të dëgjova dhe në ditë shpëtimiti të ndihmova.” Ja, pra, koha e pëlqyer, ja, pra, dita e shpëtimit.” (2 e Korintasve 6:2)

“Por Perëndia e ringjalli të tretën ditë dhe e bëri që ai të dëftohet,” (Veprat e Apostujve 10:40)

“sepse, po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtohesh.” (Romakëve 10:9)

Ajri ku ti je duke marr frymë në këtë moment është një dhuratë nga Zoti. Ai të krijoj ty në shëmbëlltyrën e Tij dhe të do shumë. Mos harro, e nesërmja nuk është e premtuar, por ti tashmë ke një mundësi, tani, për tu penduar për mëkatet e tua dhe të pranosh dhuratën e dashurisë së Zotit përmes birit të Tij, Jezus Krishtit. Kryqi nuk ishte një shpallje dobësie apo një simbol politiko-fetar, përkundrazi, është shenja e fuqisë së Zotit që na pastron nga mekati. Si rezultat i kësaj në jemi në paqe me Zotin.

Mos vdis pa Jezu Krishtin!

Mos prit, lutu tani!

Bëj këtë lutje me mua.

Ati ynë qiellor, ne emër të Jezusit, fali mëkatet e mia. Unë besoj që Jezusi është biri yt dhe që Ai jetoi, vdiq dhe në ditën e 3-të, Ti e ngrite nga varri, gjithë kjo sepse ti më deshe i pari.

Zoti Jezus, eja në zemrën time dhe bëhu Zoti i jetës sime. Më jep sigurin e shpëtimit, e cila është Fryma e Shenjtë që mbush zemrën time si nje femijë i Zotit te gjallë. Në emrin e Jezusit unë lutem, Amen.

Lutja ime për ty

Atë I shenjtë, në emër të Jezusit, unë i kërkoj Frymës se Shenjtë që të mbuloj këtë person dhe të largoj çdo mosbesim dhe çoroditje nga ai.

Kërkoj që ëngjëjt e tu ta rrethojnë këtë person të dashur nga ty, në mënyrë që të jetë i mbrojtur. At, vazhdo që ti shfaqësh të vërtetën dhe dashurinë Tënde këtij personi të çmuar. Shëro trupin e tij dhe shpëto mendjen e tij. Në emrin e Jezusit, Amen.

Për më shumë informacion

